



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 17.10.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Liburn Aliu, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Daut Haradinaj, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 10.10.2011,**
3. **Shqyrtimi i projektligjit për Banesa,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe u shtuan disa çështje tjera për pikën të ndryshme për ku përveç tjerash janë ftuar zyrtarët e KPMM.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.10.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 10.10.2011.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Banesa

Kryetari Nait Hasani ftoi anëtarët e komisionit për shqyrtim përfundimtar të projektligjit për Shitjen e Banesave dhe pas diskutimeve u vendos si vijon :

P Ë R F U N D I M

Miratohet raporti me amendamente i raportuesit Liburn Aliu.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i projektligjit për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, me amendamentet si vijon :

Amendamenti 1

Neni 2, fshihet fjalët në fund :”para datës 24 mars 1999”.

Amendamenti 2

Neni 11, fshihet pika 5 në paragrafin 1.

Amendamenti 3

Neni 28, paragrafi 2, fshihet pika 2.1.

Neni 28, paragrafi 3 riformulohet : “Mjetet e realizuara sipas paragrafit 2 të këtij neni shfrytëzohen për zgjidhjen e nevojave të banimit sipas nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit.”

Për këtë amendament komisioni votoi me 8 vota, një abstenim.

Amendamenti 4

Neni 34, në reshtin e 2 pas fjalës “ligjore” shtohet “, aktet dhe rregulloret”.

Për këtë amendament komisioni votoi me 8 vota, një abstenim.

4. Të ndryshme

- **Nait Hasani** falënderoi për pjesëmarrje Kryetarin e Bordit të Komisionit të pavarur për miniera e minerale (KPM) z. **Ahmet Tmava** dhe drejtorin z. **Azem Rexhaj** drejtor ekzekutiv i bordit dhe shkurtimisht njoftoi për shqetësimin e komisionit rreth degradimit të mjedisit për shkak të operimit ilegal të shumë operatorëve poashtu ilegal. Komisioni, vazhdoi, përmes grupit punues do të mbikëqyr ligjin për VNM ku me siguri do të ndeshet me problemet që shkaktojnë operatorët ilegal, sidomos përreth Shpellës së Gadimes si objekt me rëndësi të veçantë për Kosovën. Ai pyeti këta dy zyrtar çka kanë ndërmarr në kuadër të kompetencave të tyre për mbrojtjen e mjedisit.

z. **Ahmet Tmava** tha se KPM është fokusuar për një veprim energjik në menaxhimin me resurset natyrore me ç’rast asnjë licencë nuk lëshohet nga ky komision pa pëlqimin e MMPH (VNM) por edhe të institucioneve tjera siç janë Kuvendet Komunale, pronarët, Agjencia e pylltarisë. Ligji për miniera e minerale i cili ka hy në fuqi vitin e kaluar, komisionit në fjalë i jap drejtën edhe për konfiskim të mjeteve të operuesit ilegal, por ky mekanizëm ende nuk ka hy në fuqi ngase Agjencia kompetente për menaxhim me pasurinë e konfiskuar ende nuk ka marr kompetencat në tërësi për shkak se bisedohet ende për çështjen e transportimit të mallit të

konfiskuar si do të bëhet, depot ende nuk janë siguruar etj, përndryshe nëse kjo Agjenci është e gatshme për këtë operacion, KPMM menjëherë do të veproji (të sjellë vendimin për konfiskim). Kallximet penale, vazhdoi, tani për tani nuk japin efekte, ngase mallit të konfiskuar , si u tha më lart, nuk i dihet ende vendi. Sa i përket pronarëve pranë brigjeve të lumenjve ky komision nuk i jap licenca përtej 60 metrave afër lumit, me kushte të cekura më lartë (pëlqimet nga institucionet e cekura), për çka edhe Qeveria ka marr këtë si prioritet për shkak të operatorëve ilegal, mirëpo edhe këtu pritet hapi final nga Qeveria me akterët e cekur, për të vepruar në mënyrë sa më efikase rreth dorëzimit të pasurisë së konfiskuar.

Nait Hasani tha se këto informata janë vetëm sa për fillim, ngase grupi punues për monitorim të Ligjit për VNM tanimë është formuar bashkërisht me REC, ndaj kërkoi sqarim rreth shpellës së Gadimes pse janë dhënë pëlqimet nga kryetari i komunës, si etj., a do të thotë kjo se zyrtarët e KPMM pajtohen heshtazi me gjendjen e krijuar, pse nuk shkohet atje ngase problemet janë që nga viti 2006, sa lejohet distanca e dridhjes së tokës nga eksplozivi (1 km). Përgjigja ishte se aty licencat janë lëshuar më heret nga komuna (4-5 vjet) për shkak se distanca në mes shpellës është miratuar nga parlamenti, por megjithatë përgjegjësinë e merr ai që lëshon licencën. KPMM ju ka ndaluar punën, mirëpo në ndërkohë në MMPH është formuar një komision i cili ka lejuar vazhdimin e punimeve pa të drejt përdorimi të sasisë së caktuar të eksplozivit, me çka është konstatuar se nuk paraqitet rrezik për shpellën. **Liburn Aliu** pyeti a ka licenca të lëshuara pa VNM (leje mjedisore), sa janë kompetencat e departamentit për ujëra, sa licenca janë lëshuar për shfrytëzim dhe sa për hulumtim. Drejtori z. Rexhaj përsëriti konstatimin e kryetarit të KPMM se licenca nuk lëshohet nëse nuk ka pëlqim nga MMPH (60 m afër lumit) qysh nga viti 2007 kur është nxjerr vendimi, ndërkaq licenca për shfrytëzim janë përafërsisht 180, ndërsa për hulumtim afro 100 sosh. Licencat për hulumtim duhet ta kenë pëlqimin mjedisor dhe pëlqimin e pronarit dhe nuk lejojnë shfrytëzimin, por nëse tejkalohej kompetencat pasojnë ndëshkimet. **Afërdita Berisha** pyeti a kanë ndodhë këto tejkalime dhe sa janë për çka zyrtari u përgjigj se kanë ndodhur dhe në ato raste parashtrihen kërkesat në prokurori për ndjekje, ngase komunat ankohen për shkak të këtyre lejeve hulumtuese. **Salih Morina** u interesua konkretisht për këto raste sa janë, për çka zyrtari përmendi Pejën, Shtimen por ceku se edhe me disa komuna ka nënshkrime memorandumi për bashkëpunim. **Nait Hasani** e kishte me vëdi shkresën nga Drenasi për të cilin konfirmoi edhe **Daut Haradinaj** dhe ceku petitionin nga Pokleku e Bainca, dhe konstatuan se problemet janë në rritje të vazhdueshme. Zyrtarët e KPMM thanë se për këto raste do të përgjigjen decidivisht përmes shkresës së veçantë që do ti dërgohet këtij komisioni, mirëpo përsëritën konstatimin e lartcekur se Agjencia për menaxhimin e pasurisë nëse është i gatshëm edhe këta do të janë menjëherë të gatshëm për veprim. **Daut Haradinaj** tha se për këto raste Qeveria ka themeluar prokurorinë speciale dhe pyeti a kanë njohuri. **Sevdije Lama** pyeti pse nuk veprohet duke ju marr licencat, por ata u përgjigjën se shumica nuk kanë licenca. **Nijazi Idrizi** pyeti si veprojnë zyrtarët e KPMM pasi të marin pëlqimin nga MMPH, a formohet ndonjë komision, a verifikohet gjendja për me lëshua lejen apo si. Z. Rexhaj tha se komisioni formohet dhe konstatohet gjendja në terren por gjithnjë sipas dokumentacionit nga institucionet e cekura në fillim, ngase KPMM vetëm zbaton ligjin, pëlqimi mjedisor për këtë komision paraqet obligim. Më tutje vazhdon puna me analizën se a është çdo gjë sipas ligjit, në asnjë rast deri tani ky komision nuk ka pasur raste ku është rrezikuar jeta e qytetarëve përreth (ligji parasheh mos të jetë operatori më afër se 500 metra nëpër shtëpia). **Nait Hasani** pyeti nëse janë pëlqimet jo konform ligjit, atëherë kontrollohen nga aspekti i dokumentacionit të lëshuar nga institucioni (MMPH), u përgjigj drejtori. **Liburn Aliu** dhe **Nait Hasani** insistuan për një raport detal rreth çështjeve të lartcekura. Kryetari i Bordit tha se ashtu do të veprojnë dhe shtoi se ministri i MMPH ka ndaluar aktivitetet derisa të formohet një trup i harmonizuar rreth veprimit të përbashkët me vendim të Qeverisë. **Nijazi Idrizi** për hera tjera sugjeroi të ftohen edhe akterët tjerë që kontribuojnë në sqarimin e dilemave ose të organizohet dëgjimi publik për ballafaqim (**Sevdije Lama** dhe **Afërdita Berisha**).

Nait Hasani falënderoi dhe ftoi mysafirët të veprojnë sipas sugjerimeve të komisionit, me një raport detal me shkrim të sqarojnë çështjet e ngritura, për çka edhe grupi punues do të vizitoi këtë organ gjatë monitorimit të ligjit.

-Rreth **rekomandimeve të komisionit për monitorimin e ligjit për tokën bujqësore** u vendos që të mbahet takimi dyditor në Bërnice afër Prishtinës më 25 dhe 26 tetor 2011 me mbështetjen e OSBE, ku do të hartohen rekomandimet me ndihmën e të ftuarve siç janë: Ministria e Bujqësisë (Idriz Gashi dhe Shefki Zeqiri), MMPH, NDI, KDI , Media, MAPL dhe përfaqësues nga dy apo tre komuna (Vushtrri, Rahovec etj), Tahir Tahiri etj.

Në këtë takim do të shqyrtohet edhe mandati i komisioneve rreth ndryshimeve kushtetuese.

- Komisioni u njoftua për takimin e dt. 18 tetor në REC në orën 9,30 ku do të shkojnë 4 ose 5 deputet, si dhe për takimin e datës 19 tetor për ujëra në Emerald, ndërkaq poashtu më 19 tetor kryesuesi **Nijazi Idrizi** do të mbaj takimin e grupit punues për rregullimin e tokës me një ekspert nga Gjermania, në orën 13,00.

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani